

VENDIM
Nr. 14, datë 9.6.2014

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK PESHKOPI

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë për vendosjen e tarifave, si dhe vendimit të KKRR-së nr. 35, datë 14.10.2013, “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura për sh.a. UK Peshkopi:
 - Konsumator familjar: 10 lek/m³;
 - Institucione buxhetore: 15 lek/m³;
 - Ente private: 18 lek/m³.
2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.7.2014 dhe është i vlefshëm deri më 1.7.2015.

KRYETARI
Avni Dervishi